

Pasqyrat Financiare

WVP Fund Management Tirana sh.a

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Shoqëria "WVP Fund Management Tirana" sh a
 Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 Dhjetor 2020
 (shumat ne Lëke)

AKTIVET	Shenime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Aktivët Afatgjatë			
Aktive të patrupezuara	6	3,029,449	3,623,945
Aktive të trupezuara afatgjatë	6	2,091,753	2,450,071
Aktivët Financiare			
Totali Aktivëve Afatgjatë		5,121,202	6,074,016
Aktivët Afatshkurter			
Mjete monetare dhe ekuivalente	4	6,428,702	11,299,821
Depozita me afat	7	-	10,056,164
Bono Thesari			
Obligacione thesari	8	14,929,240	
Llogari të arketueshme dhe të tjera	9	1,161,103	414,952
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim			
Aktive të risigurimit			
Tatimi mbi fitimin	9	20,000	20,000
Aktive të tjera			
Totali Aktivëve Afatshkurter		22,539,045	21,790,937
TOTALI AKTIVEVE		27,660,247	27,864,953
KAPITALI			
Kapitali Aksionar	12	28,600,000	28,600,000
Rezervat			
Humbje të mbartura	16	(3,052,840)	(1,768,608)
Fitim/Humbja e vitit ushtrimor	16	29,609	(1,284,232)
TOTALI I KAPITALIT		25,576,769	25,547,160
DETYRIMET			
Rezerva për primet e paguara			
Te pagueshme ndaj Furnitoreve dhe të tjera	10	1,912,589	2,222,606
Detyrime ndaj Aksionereve			
Detyrimet e qirase financiare			
Detyrime tatimore	11	170,890	95,187
TOTALI I DETYRIMEVE		2,083,478	2,317,793
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		27,660,247	27,864,953


KONTABILISTE

Rrezarta Qerimi



ADMINISTRATOR

Arton Lena



Shoqëria "WVP Fund Management Tirana" sh.a
Pasqyra e Performancës për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
(shumat në Leke)

	Shenimi	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto		-	-
Ndryshimi në rezervën për primet e paguara,neto		-	-
Të ardhura neto nga Fondet Investuese		-	-
Të ardhura të tjera		-	-
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		10,039,000	7,097,024
Të ardhura neto	13	10,039,000	7,097,024
Humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes		-	-
Humbje totale dhe rregullime të humbjeve		-	-
Shpenzime administrative	14	(10,176,733)	(8,612,347)
Shpenzime të tjera			
Kosto operative		(10,176,733)	(8,612,347)
Fitimi / Humbja nga kurset e këmbimit, neto	15	(39,359)	(4,594)
Të ardhura nga interesi	15	312,763	359,234
Shpenzime interesi	15	(106,062)	(123,549)
Të ardhura financiare neto		167,342	231,091
Fitimi para tatimit	16	29,609	(1,284,232)
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin			
Fitimi/ (Humbja) e vitit	16	29,609	(1,284,232)
Të ardhura përmbljedhëse të tjera		-	-
Totali i fitimit/ (humbjes) përmbljedhës të vitit	16	29,609	(1,284,232)

KONTABILISTE

Rrezarta Qerimi



ADMINISTRATOR

Arton Lena



Shoqeria "WVP Fund Management Tirana" sh a

Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

(shumat ne Leke)

	Shënime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	13	29,609	(1,284,232)
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		-	-
Nxjerrja jashtë përdorimit		-	-
Provizjon i llogarie te arketueshme dhe te tjera		-	-
Të ardhurat nga interesi		-	-
Shpenzime interesi		-	-
		29,609	(1,284,232)
Ndryshimi në :			
- Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera		(746,151)	160,630
- Kostot e shtyra të marrjes në sigurim		-	-
- Aktive të risigurimit		-	-
- Aktive te tjera		-	-
- Rezervat teknike të sigurimit		-	-
- Të pagueshme ndaj risiguresit		-	-
- Llogari të pagueshme dhe të tjera	7,8	(234,315)	1,962,794
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		(950,857)	839,191
Tatimi mbi fitimin i paguar		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Interesa të paguara		-	-
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		(950,857)	839,191
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Të hyra nga shitja e aktiveve të trupëzuara afatgjata		-	-
Blerje të aktiveve të trupëzuara afatgjata	5	358,318	(1,730,604)
Aktive te patrupëzuara		594,496	190,732
Blerje e bonove të thesarit		-	-
Blerje e Obligacineve te thesarit		(14,929,240)	-
Rritje në depozitat me afat		10,056,164	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(3,920,262)	(1,539,872)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Të hyra nga qiratë financiare		-	-
Pagesa për qiratë financiare		-	-
Rritje kapitali	9	-	-
Flukset monetare neto të (përdorura)/ gjeneruara në aktivitetet investuese		-	-
Rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(4,871,119)	(700,681)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		11,299,821	12,000,502
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit (Shënimi 13)		6,428,702	11,299,821


KONTABILISTE

Rrezarta Qerimi



ADMINISTRATOR

Arton Lena



Shoqeria "WVP Fund Management Tirana" sh a

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020
(shumat në Leke)

Pasqyra e të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

Pershkrimi i Elementeve	Viti 2020	Viti 2019
Fitimi/Humbja e vitit	<u>29,608.57</u>	<u>(1,284,232.19)</u>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje	-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	<u>29,608.57</u>	<u>(1,284,232.19)</u>
Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		
Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	-	-
Interesat jo-kontrolluese	-	-

KONTABILISTE

Rrezarta Qerimi



ADMINISTRATOR

Arton Lena



Shoqeria "WVP Fund Management Tirana" sh a
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto me 31 Dhjetor 2019 dhe 2020
(shumat në Leke)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore statutore	Fitimi i pashperndare	Totalli
Pozicioni me 01 Janar 2017	<u>22,000,000.00</u>	-	-	<u>22,000,000.00</u>
Fitimi neto per periudhen kontabel				
Dividendet e paguar			(236,763.99)	(236,763.99)
Rritje e rezerves se kapitalit				-
Emetimi i aksioneve				-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2017	<u>22,000,000.00</u>	-	<u>(236,763.99)</u>	<u>21,763,236.01</u>
Efkti i ndryshimeve ne politikat kontabel				
Prime te kapitalit				-
Fitimi neto per periudhen kontabel				
Terheqjet e pronarit			(1,531,843.82)	(1,531,843.82)
Rritje e rezerves se kapitalit	6,600,000.00			-
Aksione te thesarit te riblera				6,600,000.00
Pozicioni me 31 Dhjetor 2018	<u>28,600,000.00</u>	-	<u>(1,768,607.81)</u>	<u>26,831,392.19</u>
Efkti i ndryshimeve ne politikat kontabel				
Prime te kapitalit				-
Fitimi neto per periudhen kontabel				
Terheqjet e pronarit			(1,284,232.19)	(1,284,232.19)
Rritje e rezerves se kapitalit	-			-
Aksione te thesarit te riblera				-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2019	<u>28,600,000.00</u>	-	<u>(3,052,840.00)</u>	<u>25,547,160.00</u>
Efkti i ndryshimeve ne politikat kontabel				
Prime te kapitalit				-
Fitimi neto per periudhen kontabel				
Terheqjet e pronarit			29,608.57	29,608.57
Rritje e rezerves se kapitalit	-			-
Aksione te thesarit te riblera				-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2020	<u>28,600,000.00</u>	-	<u>(3,023,231.42)</u>	<u>25,576,768.58</u>


KONTABILISTE

Rrezarta Qerimi



ADMINISTRATOR

Arton Lena



1. Informacione të përgjithshme

WVP Fund Management Tirana Sh.a ("Shoqëria") është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Tiranë, e cila ka si objekt të veprimtarisë mbledhjen dhe investimin e fondeve të Investimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.10198, date 10/12/2009 "Për sipermarrjet e investimeve Kolektive" si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut me qëllim jo vetëm të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, por, gjithashtu, të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre.

Shoqëria u regjistrua në Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit më 15 Nëntor 2017, dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas neneve të ligjit nr.9901, datë 14 prill 2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin nr. 10198, date 10.12.2009 "Për Sipermarrjet e Investimeve Kolektive", dhe me aktet nënligjore të tij. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në Rruga "Barrikadave", nr. 118, kati 4, ap. 1

Shoqëria është e licënsuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri bazuar në Liçnesen nr.4, datë 31 Janar 2018. Më 31 Mars 2019 "Shoqëria" është 12.31% në pronësi të aksionarit Z. Arton Lena , 1% në pronësi të Z. Ognen Tiliq, 4 % në pronësi të Z.Rubert Strobl, 2.5 % në pronësi të aksionarit Z. Ardian Kelmendi, 4.19 % në pronësi të aksionarit Z. Kujtim Ibraimi, 25% në pronësi të aksionarit "WVP"- "NDERMJETESIM NE SIGURIME" dhe 51% në pronësi të aksionarit WVP Fund Management AD Shkup.

Deklaratë e pajtueshmërisë me SNK-të

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("Lekë").

3. Politikat më të rëndësishme kontabël të zbatuara:

3.1 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

3.2 Aktivitet dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

3.3 Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

3.4 Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

3.5 Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiviteti kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të hyrë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktiviteti. Përgjatë jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivitetet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	Zhvlerësimi (%)
Pajisje elektronike dhe kompjutera	25%
Pajisje, mobilje dhe pajisje zyre	20%
Automjete	20%

3.6 Aktivet afatgjata jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri dhe aktiviteti nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiviteti jomaterial bëhet me kosto, ndërsa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

3.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha reziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

3.8 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si më poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
USD	100.84	108.64
EUR	123.70	121.77

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2019 është 5% ndërsa në ushtrimin e mëparshëm ka qene 15%.

4. Mjete Monetare (likuiditete në arkë, bankë etj.)

Gjendjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Në arkë	15,122	36,832
Në bankë	6,413,581	11,262,989
<i>Në Lek</i>	6,414,916	21,285,539
<i>Në monedhë të huaj</i>	13,786	14,282
Total	6,428,702	11,299,821

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave në fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipërisë me 31.12.2020

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

5. Aktivët Afatgjata Materiale

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivët afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

	Kompjuter dhe pajisje	Qera Zyre	Mobilje dhe pajisje	Totali
Kosto				
Më 1 Janar 2019	758,820	-	167,640	926,460
Shtesa	87,500	2,208,275	-	2,295,775
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-
Transferim te prona për investime	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2019	846,320	2,208,275	167,640	3,222,235
Shtesa	189,280	-	-	189,280
Shitje	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	1,035,600	2,208,275	167,640	3,411,515
Amortizimi i akumuluar				
Më 1 Janar 2019	349,760	373,230	49,174	772,164
Shpenzime të vitit	150,674	373,230	23,693	547,597
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-
Transferim te prona për investime	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	500,434	746,460	72,867	1,319,761
Shpenzime të vitit	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	500,434	746,460	72,867	1,319,761
Vlera kontabël neto				
Më 1 Janar 2019	571,836	-	148,082	719,918
Më 31 Dhjetor 2019	496,560	1,835,045	118,466	2,450,071
Më 31 Dhjetor 2020	535,166	1,461,815	94,773	2,091,754

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto.

Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mesiperme janë të perputhura me të dhenat e inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2020.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda mbi vlerën e mbetur, e njëjtë me atë që përdoret për qellime fiskale.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar.

Drejtimi mendon se përgjithësisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

6. Aktive Afatgjata Jo-Materiale

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për Aktive Afatgjata Jo-Materiale paraqitet si vijon:

	Programë kompjuterike	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2019	3,963,300	3,963,300
Shtesa		-
Më 31 dhjetor 2019	3,963,300	3,963,300
Më 1 janar 2019	-	-
Shtesa	-	-
Më 31 dhjetor 2020	3,963,300	3,963,300
Amortizimi i akumuluar		
Më 1 janar 2019	(339,358)	(339,358)
Shpenzime të vitit	(594,495)	(594,495)
Më 31 dhjetor 2020	(933,853)	(933,853)
Vlera kontabël neto		
Më 1 janar 2019	3,814,677	3,814,677
Më 31 dhjetor 2019	3,623,942	3,623,942
Më 31 dhjetor 2020	3,029,447	3,029,447

7. Depozita me afat

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2020 është në vlerën 0 leke si mëposhte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Depozita bankare Union Bank	-	10,000,000
Interes i përlogaritur	-	56,164
Totali i depozitave dhe fondit të garancisë	-	10,056,164

8. Obligacione thesari.

Obligacioni i thesarit me 31 dhjetor 2020 i blere në Fibank Albania me nr ISIN AL021NF10Y30, së bashku me interesin e përlogaritur dhe Zbritjen e obligacionit si mëposhte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Interes i përlogaritur	321,440	
Primi i Obligacionit (14,500,000 leke)	14,500,000	
Zbritja e obligacionit	107,800	-
Totali	14,929,240	-

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

9. Llogari te arketueshme dhe te tjera.

Llogari te arketushme perfshihen Kliente te ndryshem(Fondi i Investimeve Top Invest)qe priten te arketohen pas dates 31.12.2020.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të arkëtueshme nga Fondi i Investimeve	1,161,103	414,952
Tatim fitimi	20,000	20,000
Totali	1,181,103	434,952

10. Të pagueshme ndaj Furnitorëve dhe të tjera

Detyrimet ndaj Furnitoreve dhe te tjera ne fund te periudhes kontabel 2020 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Të pagueshme furnitorëve	1,699,471	2,058,733
Të pagueshme ndaj personelit	213,118	163,873
Totali	1,912,589	2,222,606

a- *Te pagueshme ndaj furnitoreve* ne fund te periudhes kontabel 2020 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Rampu Agency	-	49,200
Alkion Dizdari Qera Zyre	1,550,983	1,862,517
Primera Invest	148,488	147,016
Totali	1,699,471	2,058,733

b- *Te pagueshme ndaj personelit* ne vleren 213,118 leke i referohet pagave te pa paguara deri ne daten 31.12.20120.

11. Detyrime Tatimore

Detyrimet tatimore ne fund te periudhes kontabel 2020 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	85,408	84,130
Tatimi në burim	85,482	11,057
Totali	170,890	95,187

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

12. Kapitali aksionar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, është i njëjtë me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR dhe pranë AMF.

Gjate ushtrimit kontabël ka patur rritje të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe ndryshime në raportet zoterimit nga ortakët.

	31 Dhjetor 2020	
	Në %	Në Lek
Arton Lena	12.31%	3,520,000
Rubert Strobl	4.00%	1,144,000
Ardian Kelmendi	2.50%	715,000
Kujtim Ibraimi	4.19%	1,199,000
"WVP"- "NDERMJETESIM NE SIGURIME"	25.00%	7,150,000
WVP Fund Management AD Shkup	51.00%	14,586,000
Ognen Tilikj	1.00%	286,000
Totali	100%	28,600,000

13. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Shoqëria ka gjeneruar të ardhura deri në 31.12.2020 si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Te ardhura nga komisionet e hyrjes (Entry Fee)	2,480,750	1,942,924
Te ardhura nga Komisione të administrimit të Fondëve	7,558,250	5,154,100
Totali	10,039,000	7,097,024

14. Shpenzime administrative

Në këtë zë përfshihen shpenzimet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Paga personeli	2,832,037	3,471,339
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	768,864	382,673
Shpenzime për Qira	366,669	373,262
Posta dhe telekomunikacioni	140	850
Shpenzime për kontabilitetin	626,400	633,178
Shpenzime Noteriale	24,000	38,880
Shpenzime të tjera	278,727	682,471
Shpenzime Kancelarike	56,657	66,390
Shpenzime për shërbimet bankare	89,311	83,284
Udhëtime dhe transport	193,950	-
Taksa lokale	74,500	67,000
Shpenzime për konçesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	-	10,000
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	81,312
Auditim	148,380	171,564
Sherbime IT	77,756	94,541
Komisione Mirembajtje për programin Primiera 7	670,758	758,635
Sherbim Marketing	3,968,585	1,696,968
Totali	10,176,733	8,612,347

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
(Të gjitha shumat janë në Lekë)

15. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitime nga kursi i këmbimit, bruto	(39,359)	(4,594)
Të ardhura nga interesi	312,763	235,685
Shpenzime për interesa	(106,062)	-
Totali	167,342	231,091

Janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

16. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Fitimi neto llogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitim Bruto	29,609	(1,284,232)
Shpenzime te pa njohura	79,499	91,063
Humbje e mbartur	(3,052,840)	(1,768,608)
Baza llogaritjes Tatimit	(2,943,732)	(2,961,777)
% e tatim Fitimit	5	5
Tatim Fitimi		
Fitimi NETO (Humbja)	(2,943,732)	(2,961,777)

17. Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.